



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
MUNICIPAL OF ASSEMBLY- SUHAREKË
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Në bazë të nenit 12, paragrafi, 12.2, pika (d), lidhur me nenin 17, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisje lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008", e konform nenit 10, paragrafi 3, të Ligjit Nr. 04/L-174, për planifikim hapësinor, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 30/2013" e në mbështetje të nenit 13 pika 5, të Udhëzimit administrativ, MMPH-Nr.11/2015, mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planit zhvillimor komunal dhe nenit 43, pika 3 të Udhëzimit administrativ, MMPH-Nr. 24/2015, mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e hartës zonale të komunës dhe neneve 15 dhe 29, pika 2, të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë, në mbledhjen e mbajtur me datë 29.07.2026, miraton këtë:

V E N D I M

Neni 1

MIRATOHET- Raporti Monituries i zbatimit për Planin Zhvillimor Komunal dhe Hartës Zonale të Komunës së Suharekës për vitin 2023, 2024 dhe 2025.

Neni 2

Raporti i cekur në neni 1, të këtij vendimi është shqyrtuar dhe miratuar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-174, për planifikim hapësinor, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 30/2013", Udhëzimit administrativ, MMPH-Nr.11/2015, mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planit zhvillimor komunal dhe të Udhëzimit administrativ, MMPH-Nr.24/2015, mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e hartës zonale të komunës.

Neni 3

Pjesë përbërëse e këtij vendim është edhe raporti ndërsektorial për zbatimin dhe monitorimin e PZHK-së dhe HZK-së me numër të protokollit 01-Nr-052-32064 i datës 13.07.2026, i përgatitur nga Drejtoritë sektoriale komunale në bashkëpunim me Autoritetin përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor në Komunen e Suharekës, i cili është në harmoni dhe në përputhshmëri me planin e monitimit i cili është pjesë përbërëse e hartës zonal të Komunës.

Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 30, ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me neni 9, të Ligjit Nr. 08/L-284, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, publikuar në "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 24/2024" dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, (QRK) Nr. 03/2026, për procedurat e shqyrtimit administrativ të akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SUHAREKË

01-Nr- 016-35241
Më datë 29.07.2026



Kryesuesi i Kuvendit
Mr.ec Bexhet KUÇI